



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 31.07.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Migjen Shala (PDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Uran Ismaili (PDK), Florida Canolli (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Suzan Kika, e pavarur, Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK) dhe Elmire Nikçi - Rexha (LDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.
Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Osman Bllaca i njoftoi të pranishmit rreth formimit të Komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, duke bërë të ditur se ky komitet përbëhet prej 7 anëtarëve dhe ka një mandat 4-vjeçar, që do të funksionojë si trup në kuadër të Kuvendit të Komunës.

Migjen Shala bëri vërejtje rreth Propozimvendimit për caktimin e lokacionit të shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi", duke thënë se me vonesë po na sillen këto pika, kur e dimë se aty veç është bërë përrurimi i atij gurthemeli, andaj konsideroj se kjo nuk ka kuptim.

Kryesuesi tha se problemi është që në këto propozimvendime po i procedojmë me kohë, por punimet po fillojnë më herët.

Leutrim Retkoceri ngriti shqetësimin e qytetarëve për radhët e gjata të pritjeve, që janë shfaqur kohëve të fundit në Komunën e Prishtinës, për t'u pajisur me dokumente personale. Qytetarët po ankohen se kanë probleme të kryejnë shërbimet e kërkuara, për shkak të pritjeve të gjata në kohën kur ka fluks të madh të qytetarëve në Komunën e Prishtinës. Ai kërkoi që kjo çështje të futet si pikë e rendit të ditës, dhe kërkoi nga drejtoresha e Administratës, znj. Vaselika Zotaj- Asllani, të paraqet raport me informata të sakta për funksionimin e Administratës, me theks të veçantë të Sektori i gjendjes civile dhe Qendra për shërbim me qytetarë.

Vaselika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, tha se për raport sigurisht që duhet të përgatitem dhe nuk mund ta jap raportin sot. Është e vërtetë që gjatë kësaj kohe kemi pak mungesë stafi, e marrin pushimin faktikisht në këtë kohë, por nuk e besoj që të punon vetëm një sportel apo dy sportele, ndoshta është ndonjë ditë e posaçme, por në përgjithësi jo.

Rifat Deri kërkoi sqarim se për çfarë arsye nuk po sillet Projektregullorja për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave në komunën e Prishtinës. Miratimi i saj do të ishte shumë me rëndësi, pasi që do ta rregullonte qarkullimin e automjeteve që bëjnë transportimin dhe shkarkimin e mallrave të ndryshme në qytet.

Osman Bllaca bëri të ditur se sa i përket Rregullores për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave të ndërmarrjeve të ndryshme që i bëjnë gjatë ditës në qytet, jemi pajtuar që të mos ketë rregullore të tillë, por ky problem të përfshihet në Rregulloren për caktimin e orarit të veprimtarive afariste. Ajo rregullore është punuar, ka kaluar në diskutim publik, por akoma nuk është sjellë nga ekzekutivi në Kuvend.

Suzan Kika kërkoi që në mbledhjen e radhës së Kuvendit të futet në rend të ditës ndërtimi i objektit të shkollës së muzikës "Prenk Jakova".

Duhet të ceket që Shkolla e muzikës përveç standardeve për lokacion, që pothuajse në çdo shtet është afër qendrës, duhet po ashtu të ketë hapësirë me dy salla koncertale, ku mbahen koncertet e shkollës, njëra sallë më e vogël, për koncerte klasore të instrumenteve si piano, violinë, klarinetë dhe një sallë për komplet orkestrën dhe korin e shkollës.

Agim Gashi tha se ka disa muaj që Policia e Kosovës nuk ka dhënë ndonjë informacion për Kuvendin lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Prishtinës.

Është mirë që së paku një herë në vit policia të japë njëfarë informate të përgjithshme, marr parasysh ngarkesat, zhvillimet, ardhjet e diasporës, pastaj edhe çështjet tjera me rëndësi që ndërlidhen me Komunën. Kamë vërejtur një fushatë që e kish ndërmarrë policia në lagjen "Ulpiana", duke i dënuar pronarët e veturave që i parkojnë veturat aty ku gjejnë vend, andaj është obligim që Kuvendi të ketë qasje në aspektin e informatave në këtë fushë, duke marrë parasysh që gjendja në komunikacion është pak sa e tensionuar. Në këtë aspekt Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet të koordinohet me policinë, të mos veprojë policia e pavarur në këtë aspekt, sepse po bëhet njëfarë çrregullimi në aspektin e sigurisë dhe rendit në komunikacion.

Ai propozoi që në seancën e radhës kjo çështje të futet si pikë e rendit të ditës dhe të diskutojmë, sepse bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollorë dhe është shumë e domosdoshme.

Kryesuesi, konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin e projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU);**
- 3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 prill - 30 qershor 2019 (TM 2);**
- 4. Raporti i auditimit për vitin 2018 dhe Plani i veprimt;**
- 5. Propozimrregullore mbi themelimin dhe strukturimin e Asamblesë komunale të Fëmijëve;**
- 6. Propozimrregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës;**
- 7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi";**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**
- 9. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për, 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU).

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se ne kemi formuar komisionin, ku dhe i kemi trajtuar të gjitha ato vërejtje dhe sugjerime, kështu që jemi të obliguar tani ta fusim në votim, për të marrë vendimin për miratimin e Planit të qëndrueshëm të mobilitetit.

Mirsad Vitia, ne si LVV do ta votojmë këtë Plan të mobilitetit, edhe pse konsiderojmë se është i vonshëm, andaj vështirë se do të arrihet të zbatohet gjatë këtij mandati.

Leutrim Retkoceri pyeti se me këtë planë a është paraparë që punimet për zhvillimin e Planit të mobilitetit të fillojnë më herët se sezoni i verës. Sipas planit, a janë të përfshira edhe punimet për ndërtimin e rrethit në Veternik, që tash është duke u punuar, ku po krijohen kolona të gjata. Do të ishte mirë që këto punime të fillonin që nga muaji mars, pasi që komunikacioni është më pak i dendur.

Genc Bashota, drejtor, lidhur me punimet që janë duke u zhvilluar në Veternik, tha se ajo është në kompetencë të Ministrisë, do të thotë ne nuk kemi asgjë aty, sepse nga Rrethi i Flamurit e lart, e gjitha është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës.

Suzan Kika tha se gjatë kohës së shqyrtimit publik të Planit të mobilitetit janë dhënë vetëm dy komente, kjo tregon se Komuna me banorët e kryeqytetit nuk komunikon mjaftueshëm dhe për këtë duhen ndryshuar praktikatat e informimit të qytetarëve. Mendoj që televizioni publik RTK duhet të jetë dritare e hapur për kryeqytetin, prandaj një informim i gjithanshëm patjetër se duhet të ekzistojë në projektet e ardhshme që janë në interes të veçantë për komunitetin.

Agim Gashi tha se ky plan është një dokument orientues zhvillimor në fushat përkatëse afatgjate, sepse Komuna nuk mund të përballojë koston buxhetore të realizimit të plotë të një afati mandator, mirëpo ajo që është me rëndësi, është se duhet të rishikohet edhe strategjia e zhvillimit të Komunës, në mënyrë që të kemi harmoni planifikuese në vitet buxhetore dhe të orientohet drejt që ky plan të bëhet i realizueshëm.

Ky plan nuk nënkupton vetëm transportin publik, por nënkupton edhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me krijimin e kushteve për zhvillimin normal të transportit publik, siç janë shenjëzimet, ndërtimet, zgjerimi i rrjetit të transportit publik në gjithë komunën e Prishtinës etj.

Kryesuesi konstatoi se më 43 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për miratimin e projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU).

Pika e tretë

Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 prill - 30 qershor 2019 (TM2).

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, në pika të shkurtra paraqiti raportin tremujor financiar, duke thënë se gjatë periudhës raportuese Komuna e Prishtinës ka realizuar të hyrat vetanake në vlerën prej 8 milionë, apo 22.28 % nga të hyrat e planifikuara të vitit 2019. Sa u përket të hyrave vetanake për periudhën 6-mujore, nga 1 janari deri më 30.06.2019, ka bërë realizimin e të hyrave vetanake në vlerë prej mbi 14 milionë euro, apo 45.77% të të hyrave vetanake të planifikuara për këtë vit. Kryesisht performanca e këtyre të hyrave vetanake për këtë periudhë raportuese ka ardhur në masë të madhe në realizimin e taksave në tatimin në pronë, infrastrukturë rrugore, Inspeksion, Urbanizëm dhe Kadastër. Sa i përket shpenzimeve për periudhën raportuese, janë shpenzuar mbi 22 milionë euro, apo 43.99% krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2018.

Halim Halimi, fillimisht tha se është për të ardhur keq që kjo pikë po diskutohet pa prezencën e Kryetarit ose zëvendëskryetarëve. Pra, qysh është interesimi për prezencë në mbledhje, po ashtu është edhe realizimi i buxhetit për këtë 6-mujor. Shpenzimet më të mëdha i kemi ato të komunalive, pagave dhe mëditjeve dhe shumë pak kemi të shpenzimet kapitale. Kemi shumë pak të hyra prej shfrytëzimit të sipërfaqeve publike, prej grumbullimit të mbeturinave, prej parkingjeve etj. Gjatë kësaj periudhe raportuese shpenzimet kapitale janë brengosëse edhe kjo shihet mirë nga qytetarët të cilët jetojnë dhe banojnë në Prishtinë. Nëse shkojmë sipas drejtorive, ka drejtori të cilat janë me zero shpenzime dhe disa të tjera, me një përqindje shumë të vogël të shpenzimeve. Sa i përket detyrimeve kontingjente, nëse vazhdohet kështu, do të na shkojë një buxhet i tërë i Komunës për një vit. Për periudhën TM2 janë mbi 500 lëndë të paraqitura në Zyrën e avokaturës dhe konsideroj se kjo është brengosëse. Gjithashtu, Komuna po vazhdon me numrin e kontratave për shërbime të veçanta ose kontrata mbi vepër etj.

Mirsad Vitia vlerësoi se ky raport në forma tabelore dhe grafike është punuar mirë, por fatkeqësisht ky raport më së shumti paraqet mospunën e Komunës më të madhe në vend. Fillimisht, në raport thuhet se ai është i përgatitur nga Kryetari i Komunës, kurse në faqen e fundit mungon deklarata e Kryetarit. Pra, është e pakuptimtë që të mos përfshihet një vlerësim i tij në dokumentin që ai e ka detyrë ligjore që ta përgatisë, pra kjo flet mjaft për dembelinë e tij.

Tek performanca e të hyrave thuhet se kemi rritje në disa lloje të të hyrave, duke përfshirë këtu edhe Hortikulturën, gjë që mua nuk më rezulton ashtu, sepse tjetër është shkruar në tekst dhe tjetër është paraqitur në tabelën faqe 5, kur e dimë se Hortikultura ka rënie të të hyrave.

Sa i përket shpenzimeve, gjatë këtij 3-mujori Komuna vazhdon të shkëlqejë në shpenzim të buxhetit në kategoritë paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale dhe subvencione, kurse në atë të shpenzimeve kapitale është në rënie. Pra, për gjashtëmujorin e parë të vitit, as 10% e buxhetit nuk është shpenzuar në projekte kapitale.

Nëse shkojmë sipas drejtorive, ka drejtori të cilat janë me zero shpenzime dhe disa të tjera me një përqindje shumë të vogël të shpenzimeve. Pra, kjo është një pasqyrë e mos punës së këtij ekzekutivi, që do të duhej të na bënte të turpërohemi para qytetarëve edhe neve si anëtarë të këtij Kuvendi.

Leutrim Retkoceri tha se ky raport financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën prill-qershor 2019, tregon politikat komunale për mbledhjen e të hyrave tatimore dhe mbledhjen e të hyrave vetanake, që nuk është në nivelin e dëshiruar. Performanca e shpenzimeve ka trend negativ, për shkak të shpenzimeve të mëdha për mallra dhe shpenzime. Shqetësuese është se ka rënie të shpenzimeve në investime kapitale, që për Prishtinën është një dëm shumë i madh, për shkak të nevojave të shumta dhe kërkesave të shumta që ka kryeqyteti për realizimin e projekteve, si ato të çerdheve, shkollave, riasfaltimi i rrugëve, parqet dhe gjelbërimin në kryeqytet etj.

Konkretisht, ky raport tregon se ka të meta për shkak të mosrealizimit të të hyrave nga shfrytëzimi i pronave me kontrata të skaduara që janë në komunën e Prishtinës. Këto janë vetëm disa argumente që tregojnë se edhe në raport shihet sa çalon në të hyra, ndërsa ka mungesë në investime kapitale dhe ka rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

Fiknete Bejta tha se edhe ne e kemi analizuar tremujorin e raportit financiar dhe kemi arritur në përfundim se është një raport i mirë, ku janë paraqitur të gjitha elementet e nevojshme për të bërë krahasimin dhe një vlerësim të duhur. Vërehet një rritje e arkëtimit të të hyrave në krahasim me vitin e kaluar, mirëpo është një trend negativ për rritjen e shpenzimeve tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Problemi i menaxhimit financiar, edhe në këtë raport vërehet ekzekutimi jo i kënaqshëm i shpenzimeve kapitale, në vlerë mbi 3 milionë euro, ose vetëm 7.77% të planit financiar të dedikuar për buxhetimin e këtyre projekteve. Një prej faktorëve që ka ndikuar në mosrealizimin e projekteve kapitale qëndron tek Zyra e prokurimit dhe ajo projektuese, që në mënyrë urgjente duhet të riorganizohet, sepse unë e shoh problemin ose ngecjen tek kjo pjesë e menaxhimit financiar ose menaxhimit të Komunës.

Po ashtu, edhe kontigjencat ose detyrimet e raportuara po rriten dhe janë derivat i Zyrës së prokurimit në shumicën e rasteve të viteve të fundit. Shpresoj që në të ardhmen ekzekutivi të marrë për bazë këto sugjerime për ndryshim të Zyra e prokurimit.

Suzan Kika tha se rënia e shpenzimeve kapitale është tregues jo i mirë i performancës zhvillimore, andaj nuk e kuptoj arsyen e hezitimit të futjes së Komunës në projektet kapitale. E dimë që na presin shumë projekte, e dimë që Prishtina është e ngufatur dhe është më se i domosdoshëm ndërtimi i arterieve të reja të infrastrukturës rrugore, në veçanti zona jug dhe lindje, ku flitet për projektet të cilat ende nuk po fillojnë.

Hafiz Krasniqi fillimisht falënderoi drejtoreshën e kësaj drejtorie për përgatitjen e këtij raporti voluminoz dhe gjithëpërfshirës. Sa i përket pjesës së të hyrave, kemi një raport i cili paraqet një progres në realizimin e të hyrave, sidomos tek taksa, transaksionet në pronë, infrastruktura rrugore, taksat në shërbime shëndetësore etj., ku në krahasim me vitin 2018, kemi një rritje prej 22.28%.

Realizimi i të hyrave për 6-mujorin është diku në shkallen 45% të planifikimit, por, megjithatë, prapë se prapë kemi ngecje diku rreth 20-25% në fundvit. Kërkoj nga të gjitha drejtoritë komunale të atakohen me grumbullimin e të hyrave dhe të japin një azhuritet rreth grumbullimit të tyre.

Nga shpenzimet e parapara prej 22,653,397 euro, shihet se shuma më e theksuar është tek shpenzimet për subvencione, që është diku mbi 6 milionë euro, ndërsa tek pjesa e shpenzimeve kapitale kapin shumën prej 3,755,430 euro, ose 7.77%. Kjo tregon vërtetë një ngecje jashtëzakonisht të lartë, ku kemi mosshfrytëzim të buxhetit, që është tregues i një menaxhimit jo aktiv po thuajë në të gjitha dikasteret, veçmas në infrastrukturë dhe dikasteret e caktuara.

Agim Gashi theksoi se performanca e qeverisjes matet nga niveli i krijimit të të hyrave dhe sasia dhe mënyra e shpenzimit të tyre. Janë dy faqe, që në aspektin analitik e prodhojnë një performacë çoftë të lartë, çoftë të ulët, çoftë të mesme, varësisht nga parametrat matës dhe këtu del që të hyrat kanë krijuar një bazë buxhetore, por ka hapësirë për rritjen e tyre. Këtë e ka konstatuar edhe auditori në raport dhe është mirë që atë këshillim që e ka dhënë auditori, Komuna ta merr parasysh dhe ta adresojë një gjë të tillë, në mënyrë që të hyrat vetanake të krijojnë një stabilitet progresiv, jo të krijohen në mënyrë artificiale, sepse ne kemi raste kur të hyrat bëhen edhe në mënyrë jo ligjore. Është pak shqetësuese çështja e shpenzimeve të mjeteve, sepse ajo nënkupton realizimin e planit buxhetor, të cilin e ka miratuar Kuvendi në fund të vitit të kaluar, dhe dështimi i planit buxhetorë është dështim i gjithë Komunës.

Një dëshmi që krijon përshtypje në aspektin vizual, është kur i shohim prezantimet sipas drejtorive, nga 147 kode buxhetore, në 121 ka progres zero në tremujorin e dytë në raport me tremujorin e parë.

Çështja tjetër është se në këtë raport po mungon një informacion rreth një pozicioni të shpenzimeve në Trafikun Urban, për të cilën jam i bindur që ka shpenzime ose janë paraqitur në një formë tjetër, po që nuk po mundem me i identifikuar.

Shefqet Osmani lidhur me këtë raport paraqiti dy vërejtje, për të cilat tha se në faqen 22 të këtij raporti thuhet se, sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbaruesve, nga kategoria "mallra dhe shërbime" janë marrë 245,431 euro, ndërsa në sqarimin e dhënë pak më poshtë, në çoftë se i mbledh, atëherë del një vlerë prej 220,000 euro, pra ka mospërputhje. Po ashtu, edhe te detyrimet kontingjente thuhet që janë 18,325,000 euro detyrime kontingjente, në çoftë se edhe këto tabela i mbledhim, atëherë dalin 13,600,000 euro, d.m.th. janë vlera shumë të mëdha.

Leonora Shabani-Bajraktari u shpreh se sipas raportit për numrin e punonjësve në listën e pagave në Drejtorinë e Arsimit, numri i përgjithshëm i punonjësve është 3095, kurse është rritur numri aktual i punonjësve në 3155. Nga janari i vitit 2019, Komuna ka qenë e obliguar t'i punësojë edhe 12 asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta dhe kjo ende nuk ka ndodhur. Kanë kaluar 6 muaj dhe fëmijët me nevoja të veçanta ende nuk i kanë asistentët.

Shtrohet pyetja për Drejtorinë e Arsimit: Pse nuk janë punësuar këta asistentë, e që janë të domosdoshëm për fëmijët me nevoja të veçanta?

Eman Rrahmani tha se nëse fillojmë prej planifikimit të buxhetit, qysh atëherë ne kemi pasur vërejtje dhe nuk është planifikim real, është më shumë përshkrim i vit pas viti, ku tregojnë shifrat të realizimi i të hyrave dhe shpenzimeve. Planifikimi për realizimin e disa projekteve nuk po bëhet mirë, si p.sh. projekti për riasfaltimin e rrugës “Vëllezërit Fazliu”, një segment i kësaj rruge nga Reifaisen Bank e deri te semaforët në dalje të Kodrës së Trimave, është rrugë shumë e mirë, andaj nuk ka nevojë me u harxhuar mjete buxhetore.

Po ashtu, tha se premtim kanë qenë edhe ndërtimi i parqeve pothuajse në të gjitha lagjet e qytetit, dhe nga ky premtim për ndërtim të parqeve vetëm një është realizuar. Na është premtuar një park për lagjen “Kodra e Trimave” dhe në shumë e shumë lokalitete të tjera, por premtime të cilat nuk po realizohen. Gjithashtu, ka ngecje edhe në donacionet nga donatorët e ndryshëm dhe po të krahasohet me vitin kur ishte në qeverisje LVV-ja, prej donatoreve kemi pasur 123,344.00 euro, kurse në vitin 2019 kemi donacion prej 2779 euro, pra kjo është për t’u shqetësuar.

Arbenita Murseli u shpreh se sa i përket raportit financiar për tremujorin e dytë të vitit 2019, e jap vlerësimin tim pozitiv, duke pasur parasysh edhe rritjen prej 22% krahasuar me tremujorin vitit paraprak. Për më tepër, kisha dashtë me i përmendur disa projekte të Drejtorisë së Investimeve Kapitale, që shpenzimet e buxhetit të destinuar për disa projekte të përshpejtohen në bazë të kërkesave, që edhe ne si asamblistë po i marrin gjatë gjithë kohës. Një prej këtyre projekteve është rikonstruktimi i rrugës “Gazmend Zajmi”, rrugë pothuajse komplet e degraduar me shumë gropa, dhe projekti për rrugën “Xheladin Hana” në lagjen “Bregu i Diellit”, e cila lidhet me udhëkryq dhe shkakun i gropave të shumta po bëhet kolonë e gjatë në atë udhëkryq. Gjithashtu është edhe sanimi i kubzeve në rrugën “Lidhja e Prizrenit”, te Tregu i gjelbër, sepse degradimi i tyre po e rrezikon edhe lëvizjen e qytetarëve dhe po e pamundëson punën e pronarëve të bizneseve në atë zonë.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sanimi, riasfaltimi i rrugës “Vëllezërit Fazliu”, në tërësi është duke u finalizuar, si dhe është duke u ndërtuar edhe trotuari me kubze. Po ashtu, jemi duke i sanuar edhe disa rrugë të tjera, si rrugët “Robert Dol” dhe “Ukshin Hoti”.

Sa i përket projektit për sanimin e rrugës “Gazmend Zajmi”, kjo rrugë është në parakualifikim dhe pritet që këto ditë me përfunduar procesin e tenderimit.

Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, tha se sa i përket ndërtimit të parqeve, disa nga ato veç janë duke u punuar. Sa i përket parkut në lagjen “Kodra e Trimave”, në realizimin e atij projekti kemi hasur në disa pengesa nga qytetarët, ku projekti është pamundësuar që të realizohet. Jemi në kërkim të një lokacioni tjetër të mundshëm për këtë projekt.

Për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna që u ngritën nga parafolësit, **Valbona Makolli**, drejtoreshë, dha sqarime të nevojshme.

Egzon Azemi ngriti shqetësim rreth projektit për parkun në lagjen "Kodra e Trimave", duke thënë se vendi ku është propozuar ndërtimi i parkut është pronë publike dhe është e uzurpuar nga qytetarët.

Ai kërkoi nga kjo drejtori që ta analizojë këtë çështje se si është uzurpuar ajo pronë.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 15 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 prill - 30 qershor 2019 (TM2).

Pika e katërt

Raporti i auditimit për vitin 2018 dhe Plani i veprimit.

Lidhur me Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe Planin e veprimit, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Osman Bllaca**, në cilësinë e udhëheqësit të Departamentit të auditimit të brendshëm të Komunës.

Shefqet Osmani tha se roli i auditorit është që të paraqesë një pasqyrim të drejtë dhe reale të shpenzimeve të parasë publike, prandaj rekomandimet që i jep Auditori i përgjithshëm janë obliguese për të gjitha organizatat buxhetore.

Komuna e Prishtinës e ka injoruar tërësisht Auditorin, pasi që vetëm në vitin 2017, auditori kishte dhënë 25 rekomandime, kurse deri në fund të vitit 2018 i kishin zbatuar vetëm 6 rekomandime, 5 në proces, kurse 4 janë mbyllur fare pa u zbatuar.

Po ashtu, edhe në vitin 2018 auditori ka dhënë 21 rekomandime të reja, ndër to veçohen mungesa e iniciativave për rritjen e të hyrave, shpenzimet e ulëta në investime kapitale, si dhe moskryerja e auditimit të brendshëm. Pra, për vitin 2018, Komunës së Prishtinës i është dhënë "*opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes*", që kishte të bënte me faktin se shpenzimet me vlerë prej 1 milion e 432.00 euro, ishin realizuar dhe raportuar kinse gabimisht.

Raporti vjetor financiar i vitit 2018, tregon se Komuna kishte realizuar 43%, apo 16 milionë e 793.000 euro, nga 38 milionë euro sa ishin planifikuar, përderisa sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, investimet kapitale kishin një vlerë prej 15 milionë e 360.000 euro, e që në përqindje i bie realizim në investime kapitale vetëm 38% për vitin 2018, jo 43 siç ishte paraqitur në raportin financiar.

Arbër Vokri theksoi se sipas këtij raporti është konstatuar se gjetjet për këtë qeverisje komunale sipas këtij raporti, në secilën faqe janë më turpëruese se tjetrën dhe secila faqe duket më e zezë se tjetra.

Ekzistojnë shumë mangësi sa i përket qeverisjes brenda Komunës, veçanërisht në lidhje me zbatimin e ulët të rekomandimeve nga viti paraprak, sidomos ngecjet e mëdha në realizimin e investimeve kapitale që ndikojnë direkt në mirëqenien e qytetarëve të komunës.

Prej gjithsej 25 rekomandime kryesore që kanë qenë në raportin e auditorit të vitit 2017, janë zbatuar vetëm 6 prej tyre, ndërsa të tjerat kanë ngelur në proces të pazbatuara. Bazuar në këtë raport, ne do të kërkojmë përgjigje nga Kryetari.

Ky departament duket se deri tash nuk është marrë fare me kontrole të brendshme, që do të kishin përmirësuar funksionimin e dikastereve.

Në këtë raport kemi një nivel mjaft të ulët të ekzekutimit të buxhetit, pra të investimeve kapitale në vitin 2018, sikur edhe në vitet e kaluara.

Po ashtu, shihet se Komuna nuk po arrin me i menaxhuar në mënyrë efektive llogaritë e arkëtueshme, pra që janë borxhet e të tjerëve ndaj Komunës. Niveli i lartë i të arkëtueshmeve edhe mungesa e efikasitetit në mbledhjen e tyre, rrezikon që këto borxhe të vjetërsohen dhe të mos mblidhen fare, dhe kjo krijon humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën, e që kjo paraqet një shqetësim shumë të madh. Po ashtu është shumë shqetësuese edhe se shpenzimet kapitale nga mbi 20 milionë euro që kanë qenë në vitin 2016, kanë rënë në më pak se 17 milionë euro në vitin 2018.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga z. Arbër Vokri në lidhje me projektet që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, sqarime shtesë dha **Gëzim Mehmeti**, drejtor.

Leutrim Retkoceri tha se arsye të auditori ka gjetur shkelje gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Komunën e Prishtinës, mendoj se njëri nga shkaktarët është moszbatimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve, ku Komuna nuk ka të planifikuara më herët dhe nuk mund të shoh më herët pasqyrën e planifikimeve të shpenzimeve financiare. Papërgjegjësia e Kryetarit të Komunës në zbatimin e obligimeve ligjore dhe planifikimin e politikave fiskale të Komunës, ka bërë që auditori të gjejë shkelje të shumta. Nga të gjeturat, mendoj se duhet të ndalemi në pikën të urdhër blerja pas pranimit të faturës, e që mendoj se është një shkelje serioze që duhet të ketë kujdes në vitin e tashëm fiskal. **Hafiz Krasniqi** u shpreh se ky opinion ka paraqitur vetëm një theksim të çështjes, dhe atje diku flitet për disa shpenzime të raportuara gabimisht në kategori ekonomike, në vlerë prej 1 milion e 432,918 euro, ndërsa në brendi apo nëse lëshohesh në raport, vërehen se janë edhe një mori çështje dhe shkaqe të cilat ndoshta do ta kishin zbehur këtë opinion, por sidoqoftë ajo është e drejtë e auditorit. Mjaft pozitive e shoh pjesën tek prezantimi i pasqyrave financiare, që paraqesin një pamje të drejtë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Po ta analizojmë brendinë e raportit, ku theksohen një mori çështjesh si vonesat, inicimin, lidhjen e kontratave, vonesat në realizimin e punimeve të kompanive dhe mos marrja e masave ndaj këtyre kompanive, mos zgjidhja e çështjeve pronësore etj.

Eman Rrahmani kërkoi një përgjigje nga Drejtoria e Financave lidhur me dallimin në raporte financiare, diku mbi 1 milion e 200.000 euro, dhe shtroi pyetjen: A janë këto grande qeveritare që i ka tërheq Qeveria për shkak të mos shfrytëzimit në investime kapitale?

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se ai raport është bërë, ndoshta edhe është gabim, por vitin tjetër duhet me shënuar një sqarim, që raporti është me të hyrat e planifikuara, d.m.th. qysh janë planifikuar, edhe nuk e kemi çekur aty që 1 milion e diçka euro nuk kanë mundur me u realizuar. Janë dëshmitë, por vetëm nuk është çekë si vërejtje.

Agim Gashi theksoi se vendimi i 2017-ës, që Komuna garanton për blerjen e autobusëve, ka qenë obligim ligjor, sepse Komuna është pronare 100% aksionare e Trafikut Urban. Ajo është pronë e Komunës, asetet e asaj ndërmarrje janë pronë e Komunës. Shpeshherë ne kemi thënë që në pasqyrimet raportuese çoftë kreditë, çoftë vjetore, duhet me ekzistuar nja dy-tri fjali për ndërmarrjet. Kjo ka të bëjë teorikisht me kompetencat që ka Kryetari dhe Komuna në raport me ndërmarrjet komunale, pra është dashtë të jetë një pasqyrim se çka po ndodh me ndërmarrjet komunale.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i auditimit për vitin 2018 dhe Plani i veprimit.

Pika e pestë

Propozimrregullore mbi themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 1 kundër, u miratua Rregullorja mbi themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Pika e gjashtë

Propozimrregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës.

Lidhur me Propozimrregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës, të pranishmit i informoi në pika të shkurtra **Medina Braha**, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Rifat Deri kërkoi një sqarim nga drejtoresha lidhur me pikën 3.3, të nenin 14, që ka të bëjë me biletën për parking për punonjësit të cilët punojnë në zonën ku parkingu paguhet. Gjithashtu, kërkoi të dijë se çmimi për parkim të automjeteve a do të jetë i njëjtë në parkingjet private dhe ato që menaxhohen nga "Prishtina Parking".

Nol Nushi shprehu mendimin se pika 3 e nenit 14, do të duhej të shpjegonte më mirë se çka nënkupton shprehja "i privilegjuar".

Drilon Pireva tha se po të kishte qenë për automjetet komerciale në përgjithësi të bizneseve, ka njëfarë kuptimi edhe kjo, me afat të limituar jo tërëditor, d.m.th. me afat dy orësh, pra për shkak të automjeteve të cilat janë në emër të biznesit, lejohet me qëndruar gjatë gjithë orarit në këtë parking.

Eman Rrahmani propozoi që pika 3.3 e nenit 14 të hiqet, me arsyetimin se automjetet të cilat e bëjnë furnizimin e mallrave të bizneseve të ndryshme, duhet të rregullohet me Rregulloren për orarin e punës së bizneseve. Propozoi që në këto parkingje të parkohen vetëm veturat zyrtare të institucioneve ndërkombëtare. Po ashtu, vërejtje bëri edhe për nenin 4, ku propozoi që këtij nenin t'i shtohet edhe një pikë, që i parasheh edhe parkingjet nëntokësore. Vërejtje bëri në nenin 7, pika 5, ku thotë fjala *trotuar*, propozoj që kjo fjalë të hiqet. Po ashtu vërejtje bëri edhe në nenin 8, pika 1.

Agim Gashi ngriti shqetësimin lidhur me përmbajtjen e rregullores dhe gjendjen në terren, duke thënë se si do të realizohet kjo rregullore, kur në realitet mungon infrastruktura hapësinore. Asnjë hapësirë e parkingut në Prishtinë që e kemi nuk i plotëson kushtet në bazë të kësaj rregulloreje. Po ashtu, kemi hapësira private që shfrytëzohen, në Prishtinë kemi me dhjetëra të tilla, dhe në bazë të kësaj ato duhet me i mbyllur dhe Inspeksioni duhet me punuar vetëm me i penguar ato. Mendoj se kjo rregullore nuk mund të zbatohet, andaj kërkoj që kjo pikë të shtyhet për diskutim për mbledhjen e radhës.

Leutrim Retkoceri kërkoi të dijë se çka do të ndodhë me parkingjet private, si do t'i qaset kjo rregullore, po ashtu si do të jetë edhe qasja e Inspeksionit si mbikëqyrës edhe në parkingjet e tjera publike.

Egzon Azemi, propozoi që afër Spitalit të jetë edhe një parking i veçantë për gratë shtatzëna.

Kryesuesi konstatoi se për shkak të kuorumit, mbledhja u ndërpre.

Vazhdimi i mbledhjes së shtatë, më 01.08.2019.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika, e pavarur, Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA) dhe Rifat Deri (AKR-AA).

Munguan: Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Egzon Azemi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Sokol Berisha (AAK),

Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Uran Ismaili (PDK), Migjen Shala (PDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

Fatos Dibra tha se sa i përket votimeve të cilat bëhen në Kuvendin komunal, Ligji për vetëqeverisje lokale thotë se "nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj, vendimet e Kuvendit të Komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, që do të thotë se nëse në sallë ka kuorum, votat numërohen vetëm ato pro dhe kundër.

Agim Gashi theksoi se kjo rregullore nuk ka mundësi të realizohet, për shkak të mosharmonisë së madhe në mes rregullave dhe standardeve që i prezanton rregullorja dhe gjendjes faktike në terren, prandaj janë disa gjëra që duhet me i analizuar.

Eman Rrahmani tha se do të ishte mirë që të formohet edhe një grup prej asamblesë këtu, ku bashkë me personat që kanë punuar në hartimin e rregullores, të diskutohet dhe të shihen mundësitë më të mira për përmirësimin e kësaj rregulloreje.

Shefki Gashi tha se është shumë e pakuptimtë të diskutohet kjo rregullore ku në mbledhje mungojnë strukturat udhëheqëse të Komunës, që kanë me e realizuar këtë projekt. Mendoj se për me u realizuar ky projekt, paraprakisht duhet të hiqen me mijëra kuna të cilët janë vendosur në skaje të rrugëve.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Medina Braha**, drejtoreshë.

Me propozimin që pika 3.3 e nenit 14 të hiqet, kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës

Pika e shtatë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi".

Leutrim Retkoceri shprehu shqetësim, duke thënë se si është e mundshme që cilido zyrtar i Republikës së Kosovës fillimisht me i vënë gurëthemelet, e pastaj me i kërkuar lokacion Kuvendit të Komunës së Prishtinës?!

Po ashtu, edhe një keqkuptim që ka ndodhur në këtë shesh, më herët ka qenë i emëruar sheshi "Adem Demaçi", para se me vdekur i ndjeri, ndërsa më vonë është riemëruar "Parku i të dashuruarve", ka qenë një hajgare e madhe këtu edhe prej qeverisjes së kaluar.

Vlora Dumoshi tha se me rastin e vendosjes së shtatores së Adem Demaçit është bërë një shkelje shumë e madhe, një praktikë të cilën asnjëherë nuk e ka pasur Komuna e Prishtinës.

Pakënaqësitë për shtatoren janë të mëdha, ku edhe familja e tij ka reaguuar. Tash ne duhet ta shohim se për cilin vend po e votojmë vendimin, se tash nuk po e dimë a te Universiteti, apo aty ku është vendosur gurthemeli.

Vala Peshku shprehu mendimin që Kuvendi komunal ta dërgojë një notë proteste lidhur me veprimin që e ka bërë niveli qendror.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi".

**Pika e tetë
Pyetje dhe përgjigje.**

Sami Boroci, për kryesuesin e Kuvendit:

- Kërkoj në emër të Kuvendit komunal, që në objektin e Komunës së Prishtinës të gjendet një hapësirë për grupet parlamentare me u takuar me qytetarë.
- Po ashtu, kërkoi të dijë se deri ku ka arritur procedura për furnizimin me llap top për anëtarët e Kuvendit, pasi që për këtë çështje është diskutuar disa herë, por veprime konkrete nuk janë marrë asnjëherë.

Kryesuesi tha se e vetmja mundësi është që të shfrytëzohet salla nr. 37, vetëm duhet të rezervohet termini, ndërsa sa i përket një hapësire të veçantë, përgjigjja nga Drejtorja e Administratës ka ardhur se nuk ka mundësi që të sigurohet hapësirë për grupet parlamentare.

Sa i përket llaptopëve, tha se çështja është në procedurë dhe tani është koha me e zgjidh këtë problem.

Leutrim Retkoceri, për drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës:

- Kërkoj nga kjo drejtori një raport pune, konkretisht për Sektorin e gjendjes civile dhe të Sektorit të shërbimit me qytetarë, dhe kërkoj të dijë se çka është duke ndodh me administratë në kohën kur ka fluks të qytetarëve edhe kërkesa të shumta të bashkatdhetarëve. Konsideroj se mosprezsenca e drejtoreshës së Administratës në këtë Kuvend është tepër jo serioze. Është shumë esenciale me ditur se çka është duke ndodhur te Sektori i gjendjes civile dhe te Sektori i shërbimit me qytetarë.
Është keq për një Kryetar të Komunës, që është zyrtari më i lartë brenda Komunës së Prishtinës, mos me pasur kontroll absolut në drejtorët e vet. Kjo tregon për një mjerim të qeverisjes lokale në Prishtinë.

Naime Osmani, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve, për Sektorin e burimeve njerëzore dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave:

- Kërkoj nga Drejtoria e Parqeve që t'i sugjerojë ndërmarrjes publike "Hortikultura" për ta pastruar rrugën Besi - Rimanishtë, e cila është e mbyllur prej drurët dhe bari.
- Kur do të nisin punimet për rregullimin e ndriçimit të rrugëve "UÇK", përballë Procredit Bank, dhe "Rexhep Krasniqi", në lagjen "Kalabria", që prej se janë vendosur kabllot nëntokësore, janë larguar shtyllat e ndriçimit dhe tani nuk kanë fare ndriçim?
- Lidhur me konkursin e fundit për Qendrat sociale për të moshuar, qytetarët pyesin si ka mundësi që kriter është shkolla e mesme, e cila mund të jetë shkollë bujqësore, ekonomike apo teknike, kur dihet që punëtorët socialë duhet të jenë me fakultet adekuat dhe të trajnuar, mos ua kanë përshtatur këtë konkurs njerëzve të tyre, d.m.th. partia në pushtet apo militanteve?
- Disa mësimdhënës që janë pranë pensionit, pyesin se kur do të bëhen pagesat e 6 pagave 3+3, pa vendim të gjykatës, pse të vrapohet nëpër gjykata për këtë të drejtë që ju garanton ligji dhe kontrata kolektive.

Valbona Makolli, drejtoresh e Drejtorisë së Financave, tha se sa i përket pagesës për mësimdhënësit, kam parashtruar si kërkesë se qysh mundet me lidh marrëveshje ose kontratë mes ministrit të Arsimit edhe Sindikatës, për me paguar Komuna pa qenë prezent askush prej Komunës aty. Mirëpo Gjykata po iu njuh atë të drejtë punëtorëve edhe na u kanë marr përmes përmbaruesve. Tash unë e kam nxjerrë edhe listën sa kanë qenë prej vitit që është hy në fuqi për pagat jubilarë, dhe është një shumë e Komunës, i duhen diku rreth 2 milionë euro, mirëpo për ato pagat retroaktive Ministria nuk na ka përkrahur, por prej vitit 2018-2019 veç janë në qarkoren e parë. Personeli e ka për obligim për punëtorët e Arsimit edhe të Shëndetësisë që dalin në pension, me dërguar kërkesën me iu paguar pa shkuar përmes Gjykatës.

Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe menaxhimit të Kontratave, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Objekti i shtëpisë së Kulturës në lagjen "Hajvalia" është në rrënim e sipër, andaj është kërkesë e banorëve të kësaj lagjeje që Komuna të ndërmarrë masa që ta rrënojë dhe pastaj ta ndërtoj një objekt të ri. Ky ka qenë edhe premtim i vitit 2017 nga z. Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës.

- Kur do të fillojnë punët për vazhdimin e mbulimit të kanalizimit në rrugën "Fadil Vitia", do të thotë aty nën urën e cila është ndërtuar dikur, nën të kalojnë ujëra të zeza dhe në anën e majtë të urës janë mbuluar ato ujëra, kurse në anën e djathtë vazhdojnë me qenë në ambient të hapur. Është kërkesë e banorëve të asaj lagjeje.
- Në rrugën publike "Brigada 153" të lagjes "Hajvalia", banorët aty ndërtojnë në rrugë "policë të shtrirë", kurse Komuna nuk ndërmerr asnjë hap konkret. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ose nga Drejtoria e Inspeksionit, që t'i largojë ato pengesa, ose t'i gjobisë ata persona të papërgjegjshëm të cilët e shfrytëzojnë pa asnjë leje të drejtën për të ndërtuar në rrugë publike.
- Pyetja tjetër ka të bëjë me ndërtimin e rrugës së banorëve që jetojnë përballë "Daimond Rezidencë", në rrugën kryesore Prishtinë - Gjilan, që ndodhet përballë banesave të Pacollëve, siç njihet në lagjen "Hajvalia". Kjo kërkesë është parashtruar më se 4-5 herë, mirëpo nuk është marrë asnjë përgjigje nga Komuna.

Suzan Kika, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Në Matiçan dhe Hajvali po hidhen inertet nga gërmimet e ndërtimeve, dhe nga kjo dukuri faqja e kodrës po degradon plotësisht. A ka ndonjë vendim që parasheh hedhjen e këtyre mbeturinave inerte në ato pjesë, dhe a janë këto në harmoni me planin e mbrojtjes së ambientit.

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për Sektorin e Burimeve Njerëzore, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

1. Kush dhe përse po i merr vendimet, që rrugët e qytetit të rregullohen ose riparohen në muajt e verës korrik-gusht, kur dihet mirë që komunikacioni më i dendur në qytet është gjatë këtyre dy muajve, pasi që vijnë mërgimtarë të shumtë nga të gjitha anët e botës?
2. Pse nuk janë ftuar për intervista aplikantët e konkurseve në komunën e Prishtinës gjatë këtyre 6 muajve të fundit? Pse asnjë aplikant i Prishtinës nuk është ftuar, vallë këto konkurse po hapen sa për sy e faqe?!
3. Edhe sa kohë do të zvarritet pranimi teknik i objekteve kolektive, proces ky i cili po zhvillohet me hapa të breshkës, a mundet ekzekutivi ta përshpejtojë këtë proces, sepse investitorët po humbin milionat?
4. Pse po lejohet shkatërrimi dhe degradimi i parkut "Gërmia", duke mos i marrë masat e nevojshme teknike për mbrojtjen e natyrës dhe ambientit për aktivitetet e ndryshme në këtë park?
5. Pse nuk po merren masa emergjente për hapjen dhe pastrimin e kanalizimeve në qytet, madje intervenimi i Komunës në disa pjesë të qytetit, si në lagjet "Arbëria", "Tophane",

“Qendra”, “Pejton”, duhet ndërruar të gjithë strukturën e vjetër të gypave, ngase pas reshjeve më të vogla në qytet, shpërfaqja dhe rrjedha e tyre rrugëve të qytetit po shkakton kundërmim, papastërti si dhe rrezik për epidemi të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi



Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta